
STATUTI **i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar** **“Loren 72” SHPK**

Parashikimet e ketij Statuti zbatohen per nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (SHPK).

Ne kete statut:

- Ligji - eshte Ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008 “Per Tregtarete dhe Shoqerite Tregtare” I ndryshuar;
- Statuti - eshte Statuti i shoqerise;
- QKB” – Qendra Kombetare e Biznesit ne Shqiperi.

KREU I **Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Me 28.05.2025, regjistrohet shoqeria “Loren 72” shpk me ortakete saj, shoqerine K M P K e pajisur me nipt K51410005E, perfaqesuar nga ortaku i saj Z. Lorenzo Mesiti e datelindjes 20.10.1972 i pajisur me karten e identitetit shqiptare H21020112C, bazuar ne akt themelimin e dates 28.05.2025.

Neni 2

Objekti

2.1 Poste karikimi makina elektrike, shitje blerje makinsh, dhenie makinash me qira. Taksi bar kafe restorant, lavazh. Aktivitet ne fushen e hoteleri-turizimt. Projektimi, prodhimi, riparimi dhe montimi i pajisjeve, makinerive dhe linjave complete ne fushen e industrise ne teresi, e ne vecanti te asaj minerare, te prodhimit te materialeve te ndertimit dhe te industrise se riciklimit (se letres, plastikes, drurit, qelqit etj); Projektimi, prodhimi, riparimi dhe montimi i pajisjeve te industrise se naftes dhe te gazit, si dhe nenprodukteve te tyre; Projektimi, prodhimi, riparimi dhe montimi i impianteve te ventilimit, te filtrave industriale, te pneumo-transportit; Projektimi, prodhimi, riparimi dhe montimi i kapanoneve industriale, magazinave te ndryshme dhe objekteve industriale dhe civile ne disa kate, prej celikut dhe membranave metalike te varura; Projektimi, prodhimi, riparimi

dhe montimi i siloseve, ushqyesve, transportiereve qe perdoren ne industrine e prodhimit te materialeve te ndertimit, ate ushqimore etj. Projektimi, prodhimi, riparimi dhe montimi i eneve nen presion, tubacioneve te rezervuareve per lende djegese dhe kimikate, te separatoreve etj.; Projektimi, prodhimi, riparimi dhe montimi i ashensoreve, vincave dhe paisjeve ngritese te madhesive dhe tonazheve te ndryshme; Projektimi, prodhimi dhe montimi i mbikalimeve, soletave prej metali, dyer dhe porta metalike, rrethime objektesh me kangjella etj; Projektimi, prodhimi dhe montimi i shtyllave te tensionit te larte, te kryqezimeve te linjave, te tubacioneve dhe agregateve te HEC-eve, TEC-eve, te impianteve te prodhimit te energjise nga burime alternative dhe te rinovueshme etj, Shoqeria mund te kryejë veprimtari te tjera te lidhura ose ne funksion te realizimit te objektit si me siper. Aktivitet ne fushen e ndertimit si dhe cdo aktivitet qe lejohet nga legjislacioni shqiptar.

Neni 3

Kohezgjatja

3.1. Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pacaktuar.

Neni 4

Selia

4.1. Selia e shoqerise ndodhet ne Fushe Preze, Tirane ne adresen: Rruga Fushe Preze, Ndertesa ne zonen kadastrale 1669, Nr. Pasurise 10/55

KREU II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

5.1 Kapitali fillestar i kompanise do te jete 1 000 000 leke te ndare ne 1 kuote me vlere nominale 1 000 000 leke per kuote ku:

Shoqseria K M P K, zoteron 1 kuote me vlere 1 000 000 leke qe perfaqeson 100% te kapitalit.

5.2. Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

6.1. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

6.2. Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

6.3. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

6.4. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

7.1. Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;

b) shitblerjes;

c) trashegimise;

ç) dhurimit;

d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

7.3. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III

Organet Vendimmarrese dhe Drejtuese

Neni 8

Organi Vendimmarres

8.1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

8.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

8.3. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:

a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;

b) ndryshimet e statutit;

- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
 - ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
 - dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
 - i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.
- 8.5. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.
- 8.6. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

- 9.1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- 9.2. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortakët jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10

Kuorumi

- 10.1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.
- 10.2. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me

shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

10.3. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

11.1. Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

11.2. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

11.3. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

12.1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

12.2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13

Administrimi

13.1. Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riprteritjeje.

Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

13.2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundërshtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

13.3. Znj. Emine Mesiti e pajisur me pasaporten shqiptare me numer H36217024V e datelindjes 17.12.1973 eshte Administratore e shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

Neni 14

Kompetencat e Administratoreve

14.1. Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

14.2. Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

14.3. Nëse asambleja e përgjithshme emeron me shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

14.4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padite, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

15.1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

15.2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

15.3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administrator detyrohet:

15.3.1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në keto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe menjëherë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

15.3.2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

15.3.3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë dëm, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga keto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

15.4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë dëm e shkaktuar, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividende;

c) u shperndan aktivet shoqerise;

ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

15.5. Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit. Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

16.1. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

17.1. Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

17.2. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V

Prishja –riorganizimi i shoqerise

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

18.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;

b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave te falimentimit;

ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit";

d) me vendim te gjykates;

18.2. Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

18.3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

18.4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

18.5. Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

19.1. Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

20.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

20.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

ORTAKU I SHOQERISE

Shoqeria K M P K
Perfaqesuar nga ortakut
Lorenzo Mesiti

